

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Shërbim GPS dhe monitorim per autoambulancat

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 38112100-4 -
Sisteme gps ose të ngjashme**

VLERA E FONDIT LIMIT: Fondi limit i parashikuar i Marreveshjes Kuader per 12 muaj: 9.804.000 (nëntë milion e tetëqind e katërmijë) lekë pa TVSH, cmimi për njësi për një GPS në muaj është 2.150 (dy mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; në vlerën 196.080 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëdhjetë) lekë (shuma e shprehur me fjalë).*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(ndryshuar)

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Operatori ekonomik duhet të paraqesi certifikatat për përmbushjen e standarteve si më poshtë vijon:

- ISO 9001:2015 ose ekuivalente;

- ISO 14001:2015 ose ekuivalente
- ISO 27001:2013 ose ekuivalente

Certifikatat e mesiperme duhet te jenë të lëshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te cilat jane te akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat nderkombetare akredituese te njohura nga Republika e Shqiperise). Çertifikata të jetë e vlefshme dhe te kete lidhje me objektin e prokurimit. Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik certifikatat duhet te paraqiten nga secili prej anetareve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 dhe 79, të LPP ku parashikohet se:

Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", te ndryshuar .

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Xhiroja minimale vjetore për 3 vitet e fundit duhet te ketë një vlerë jo me te vogel se 40 % e vlerës së fondit limit. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjate tre viteve te fundit. Sqarojmë se kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$$40 \% * 9.804.000 = 3.921.600 \text{ Leke}$$

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetary.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Shërbime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të fondit limit që prokurohet, të realizuara gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme.

- Për kontrata me institucionet shtetërore duhet të paraqitet kontrata dhe vërtetimi për realizimin me sukses të saj ose kontrata dhe faturat tatimore të shitjes.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Faturat duhet të jenë të deklaruara në organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 dhe neni 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar, ku parashikohet se:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Neni 55 i VKM parashikon:

-
- a) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës.

$20\% \times 9.804.000 \text{ Leke} = 1.960.800 \text{ Leke}$

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve se ka jo më pak se 10 punonjës të siguruar për 3 muajt e fundit, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore

(formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore, ku perfshihen *(duke paraqitur deklaratimet në sistemin elektronik të tatimeve, me kodin përkatës)*

- (a) 5 (pese) punonjes te deklaruar si montues te pajisjeve elektronike ose profesione ekuivalente
- (b) 1 (një) Inxhinier elektronik ose ekuivalent
- (c) 1 (një) Inxhinier Telekomunikacioni ose ekuivalent

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4 paragrafi b) i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e tyre te nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

Të gjithë specialistët e kërkuar janë të nevojshem për realizimin e shërbimeve të kërkuara në specifikimet teknike të kësaj procedure. Disponimi i stafit teknik të kërkuar krijon bindje tek Autoritetin Kontraktor se OE ofertues ka kapacitetet profesional për realizimin e kontratës. Montuesit e pajisjeve elektronike jane stafi i drejtperdrejte i O.E qe do te merret me instalimin e pajisjeve GPS ne autoambulanca. Inxhinieri elektronik ose ekuivalent është i nevojshëm gjatë procesit të ofrimit të shërbimit të monitorimit në rast se do të evidentohen defekte në pajisjet GPS. Inxhinieri i telekomunikacionit ose ekuivalent është i nevojshëm gjatë procesit të ofrimit të shërbimit të monitorimit në rast se do të ketë ndërprerje të transmetimit të sinjaleve GPS. Punonjësit e certifikuar nga prodhuesi janë garanci për AK se operatori ekonomik ka aftësi profesionale të vërtetuara për pajisjet që do ti lërë në përdorim AK dhe do jetë në gjendje të mbulojë cdo problematikë të tyre.

- 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kataloge për pajisjet që do të përdoren për kryerjen e shërbimit duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e kuotuar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. (Katalogu te permbaje karakteristikat teknike te cdo artikulli me qellim që autoriteti kontraktor te gjykoje nese plotesohen kerkesat teknike te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike te markes dhe modelit te kuotuar do te krahasohen me katalogun e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST per perputhshmerine e tyre).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4 ç) i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë materialet e nevojshëm për të ofruar shërbimin pasi të gjitha pajisjet te nevojshme per ofrimin e sherbimit do të lihen në përdorim për AK nga operatori ekonomik.

- 2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për produktet e GPS, ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vertetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe prodhuesit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4 paragrafi ç) i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që gëzojnë autoritetin e duhur të deleguar nga prodhuesi për të shërbyer në pajisjet që do të mirëmbajnë. Kjo minimizon riskun për mos respektimin e kushteve të kërkuara mbi kohën dhe cilësinë e shërbimeve që do të ofrohen.

- 2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të lëshojnë deklaratë nëpërmjet të cilës merr përsipër montimin, instalimin, konfigurimin, testimin për pajisjet si dhe të marrë përsipër të trajnojë stafin me specialistë të certifikuar nga prodhuesi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 paragrafi ç) i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që gëzojnë autoritetin e duhur të deleguar nga prodhuesi për të shërbyer në pajisjet që do të mirëmbajnë.

- 2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente për prodhuesin e pajisjeve. Ofertuesit që nuk e disponojnë certifikatën ISO 9001:2015 (ose ekuivalente) të prodhuesit në momentin e hapjes së procedurës së prokurimit duhet të paraqesin vetëdeklarim me shkrim se prodhuesi disponon këtë certifikatë dhe se kjo certifikatë do të paraqitet nga ofertuesi në momentin e lidhjes së kontratës me AK.” Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatat e konformitetit të pajisjeve të ofertuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 dhe 79, të LPP ku dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar . Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që gëzojnë autoritetin e duhur të deleguar nga prodhuesi për të shërbyer në pajisjet që do të mirëmbajnë. Kjo minimizon riskun për mos respektimin e kushteve të kërkuara mbi kohën dhe cilësinë e shërbimeve që do të ofrohen.

- 2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) automjete për shërbimet e mirëmbajtjes, shoqëruar me kontratë shitblerje ose certifikatë pronësie ose kontratë qiraje të noterizuar si

dhe për të gjitha mjetet të paraqitet certifikata e pronësisë, leje qarkullimi, vërtetim për taksat e paguara dhe siguracion i vlefshëm.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4 ç) i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e nevojshme për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

2.3.8 Ofertuesi ditën e hapjes së ofertave duhet të demonstrojë funksionalitetin e software-it. Për këtë demonstrim duhet të paraqesë mostrat e pajisjeve të kerkuara në specifikimet teknike sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Përshkrimi i mallrave
1	GPS për automjete
2	Kamera për pajisjet GPS
3	Sistemi Audio – Video
4	Software

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6 a) i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë materialet e nevojshme për të ofruar shërbimin pasi të gjitha pajisjet do të lihen në përdorim për AK nga operatori ekonomik.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Emertimi	Specifikime Minimale
Voltazhi hyres	DC 11V~36V/1.5A
Bateri reserve (stand by)	Po
Konsumi i Energjise	8mA
Temperaura ne gjendje pune	-5°C~75°C
Lageshtia	5%~95%
Oret e Punes	40 ore ne opsionin e ruajtjes se energjise dhe 4 ore ne gjendje pune normale
Button/Switch	Buton SOS (per te derguar mesazhe ose thirrje) Buton power
memorje	7MB
Sensor	3D sensor shpejtesie
Frekuenca GSM	GSM 850/900/1800/1900MHz
Sensiviteti GPS	-161dB
Saktesia e Pozicionit	3 m

Emertimi	Specifikime Minimale
I/O	3 inpute dixhitale (2 hyrje negative and 1 hyrje positive) 2 hyrje analoge detection 2 outpute 1 porte RS232 1porte USB port 1porte per sensor temeperature dixhitale 1 Wire iButon

SERVERI QENDROR

- Hapesira ne server duhet te mbulohet nga Operatori ekonomik fitues per periudhen qe mbulon kontrata, nga data e marrjes ne dorezim te pajisjeve apo instalimit te tyre.
- Serveri duhet te kete lidhje te dedikuar me fiber optike 100 Mbit/s (Upload/Doenload).
- Serveri duhet te jete ne Republiken e Shqiperise fizikisht kjo te vertetohet nga IP statike qe do te perdore.
- Sistemi duhet te kete 2 Linja backup (1 tokesore dhe 1 Ajrore) Te vertetohet me nje vertetim nga ISP vendase
- HDD per ruajtjen e historikut dhe te te dhenave jo me te vogel se 2 TB.
- SSD per sistemin operativ.
- Procesor server jo me te vogel se Core i7 ose ekuivalent (6x3.2 GHz).
- RAM jo me pak se 64 GB.

SPECIFIKIMET MINIMALE TEKNIKE TE KAMERES

Normal Standby

Konsumi I Energjise 25mA

Temperatura ene gjendje pune -20°C~55°C

Lageshtia ne gjendje pune 5%~95%

Voltazhi ne gjendje pune 5V

Rezistenca e Brendshme3.6R

Rezolucioni 1000 TVL

Baud Rate 115200bps

AUDIO

Paisja GPS te suportoje mikrofoni dhe bokse.

Te jete e pajisur cdo paisje me nje mikrofoni dhe nje boks per marjen dhe dergimin e sinjaleve AUDIO

KAMERA

Sistemi GPS te jete i pajisur me nje kamere per fotografimin ne cdo moment qe do gjykohe e nevojshme nga perdoruesi i sistemit.

SPECIFIKIME TEKNIKE(MINIMALE) TE KOMPJUTERIT

Chipset: Intel or equivalent

Madhesia e HDD: 250GB

Shpejtesia e HDD: 7,200 rpm SATA 3.0Gb/s

Grafika: 256 video memory

Tastiera: Standart keyboard English

Mouse: Minimum 2 Button scroll optical

Porta: Rear(6) USB 2.0, (1) RJ-45, audio in/out, Front : (2) USB, headphone, microphone

Netëorking: 10/100/1000 LAN integrated Gigabit Ethernet card

Speakers: Sound Card

Sistemi i operimit: OEM Windows 7 Professional Edition Licensed

TERMAT E REFERENCE

SOFTWARE I GPS

- Mbulim te sakte te hartes se Shqiperise.
- Emertim i sakte i rrugeve
- Informacion mbi mjetin dhe kohen e tyre te gjurmimit.
- Informacion mbi historikun e levizjes.
- Mundesi printimi te hartes me historikun e levizjes
- Harte open source ose OSM satelite, pamje reale dhe terren.
- Rifreskim i hartave dhe software jo me vone se tre muaj.
- Licensen e hartave te blere.
- Raporte te detajuara mbi cdo aktivitet .
- Njoftim me sms per alarme.
- Percaktim te zones se punes.
- Percaktim te rregullores se hyrjes dhe daljes nga vendi i punes.

- Mundesi lidhje me API.
 - Alarm per mos prezence.
 - Alarm per qendrim per kohe te gjate ne nje vend te caktuar
 - Alarm per hyrje/dalje ne vendin e punes.
 - Alarm per shkeputje baterie.
- ☐ Alarm per dalje / hyrje nga cdo kufi i Shqiperise.
 - ☐ Raportim per levizje te mjetit.
 - ☐ Alarme në kohë reale me nëse mjeti leviz mbi shpejtësinë e lejuar, qëndron për një kohë të gjatë me motor ndezur pa lëvizur, devijon nga rruga e paracaktuar, hyne dhe del pas orarit te lejuar nga zonat e parkimit, shkëputjes së pajisjes GPS nga mjeti.
 - ☐ Njoftim me sms per alarme.
 - ☐ Fotografi ne kohe reale
 - ☐ Transmetim audio per marje sinjali dhe dhenie sinjali (IN-Out Mikrofon dhe bokse)
 - ☐ Mundësine e përcaktimit të vendndodhjes së automjetit në distance në çdo moment.
 - ☐ Transmetimet e paisjes cdo 10 sekonda
 - ☐ Informacion i detajuar për çdo makinë : Identifikimi i mjetit, shpejtësinë e lëvizjes, nëse është ndezur ose fikur, adresën e vendndodhjes.
 - ☐ Raporte për kilometrat e përshkruara, orët e punës, shpejtësinë maksimale dhe shpejtësinë mesatare, orët e qëndrimit me motor ndezur pa lëvizur (idle time), kohën e fikjes/ndezjes.
 - ☐ Koha e qëndrimit në pozicionet e parkimit dhe pikat e interesit.
 - ☐ Raporte ditore, javore, mujore të përmbledhura në tabela dhe mundësinë për tu exportuar dhe printuar në format pdf dhe excel.
 - ☐ Përcaktimi i zones së parkimit për çdo mjet dhe lajmërimet nëse mjeti bën lëvizje të pa identifikuar nga kjo zonë.
 - ☐ Përcaktimi i pikave të interesit dhe raporte për kohën e mbërritjes, qëndrimin dhe kohën e largimit nga këto pika interesi.
- Platforma te ofroje mundesine e lidhjes dhe te sistemeve video
- ☐ Monitorimin i mjeteve nga telefoni dhe çdo pajisje smart. Aplikacion per Telefon(IOS-ANDROID)
 - ☐ Mirëmbajtje dhe kontrole periodike hardware dhe software
 - ☐ Software duhet te jete ne gjuhen shqipe

Raportet apo cdo informacion tjetër i nevojshëm do të jetë i aksesueshëm në kohë reale përcaktohet nga Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore dhe nga cdo Autoritet Kontraktor (Perfitues).

OE te ofertojdenje user demo ku mundet te verifikoje AK funksionalitet e softwarët

SUPORTI

- Instalimi duhet te behet nga persona te kualifikuar.
- Kualifikimi i personave duhet te vertetohet me çertifikate kualifikimi.
- Operatori ekonomik duhet te levroje Sherbimin GPS brenda 5 diteve nga data e nenshkrimin te kontrates.(Percaktuar sipas Grafikut te Levrimin)

- Koha e zëvendësimit të pajisjes në rast defekti nuk duhet të jetë më tepër se 12 orë nga njoftimi i Autoritetit Kontraktor.
- Operatori ekonomik ka për detyrë të bëjë trajnimin e stafit të Autoriteteve Kontraktore (Perfituese) përpara dorëzimit të pajisjeve dhe të jetë i gatshëm që për periudhën që mbulon kontratën, në bazë të kërkesave të Autoriteteve Kontraktore (Perfituese), të organizojë me shpenzimet e veta, trajnimin e punonjësve të caktuar nga Autoriteti Kontraktor (Perfituese).
- Suport të vazhdueshëm për 24 orë në ditë.

SISTEMI I VEZHGIMIT

Të kete mundësi fotografimi në rastet e alarmeve, të ndezjes dhe fikejes së mjetit, në rastet kur ka emergjencë dhe të bëjë fotografi periodike nga një kohë që e përcakton administratori i sistemit. (sipas konfigurimeve të administratorit QKUM)

SISTEMI AUDIO

Ky sistem duhet të jetë i lidhur me pajisjen GPS dhe të ofrojë komunikimin audio të Ambulancave me Sallen Operative në Qendren Kombëtare të Urgjencave Mjekësore. Në rastet që do të kete emergjencë me anë të butonit të panikut personeli i ambulancës do të komunikojë me sallën operative në kohë reale. Gjithashtu dhe nga ana e sallës operative nëpërmjet sistemit të GPS mund të komunikohet me ambulancën.

Paisjet

Telefoni do vendoset në sallën operative.

Mikrofoni dhe boksi do instalohen bashkë me pajisjen GPS dhe kamerën në ambulancë.

SALLA OPERATIVE

Kompania fituese do të marrë përsipër instalimin e sallës operative në ambientet e Qendres Kombëtare të Urgjencës Mjekësore. Kjo sallë do të shërbejë për monitorimin në kohë reale të ambulancave. Në këtë sallë do të vendosen 2 monitore LED 52" dhe 1 kompjuter për monitorim. Në cdo qendër spitalore kompania do të krijojë mundësinë e monitorimit të ambulancave që i perkasin cdo drejtorie.

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

“Shërbimi GPS dhe monitorim për Autoambulancat” – Marreveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

Kontratat do të lidhen sipas afateve të përcaktuara nga AK dhe sipas nevojave për vendosjen e GPS në autoambulancat e shërbimit të urgjencës në gjithë territorin e RSH.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Në autoambulancat e Spitaleve, Urgjencën Mjekësore Tiranë, në Qendren Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, Qendrat Shëndetësore, Insitucione të tjera sipas rastit dhe nevojave.

NJËSIA E PROKURIMIT:

1. Ermira Muçaj Specialiste Prokurimi
2. Klejdi Cankja Përgjegjës i Sektorit të Njesisë së Koordinimit të Urgjencave
3. Blerim Ademaj Specialist Investimesh